

Në Krakov ndërtohet një tjetër kishë orthodhokse



Kisha Orthodhokse Autoqefale e Polonisë kërkon të jetë më e pranishme në Krakov të Polonisë, meqenëse kohët e fundit ka pasur shumë prurje emigrantësh në këtë qytet, kryesisht të ardhur nga Ukraina, shumica e të cilëve (67.3%) e identifikojnë veten si të krishterë Orthodhoksë. Aktualisht, në këtë qytet ka vetëm një kishë orthodhokse, e cila nuk është më e mjaftueshme.

Krerët e qytetit morën në konsideratë rreth 1700 vende të volitshme për ndërtimin e kishës, dhe në përfundim vendosën t'i shisnin Kishës një truall në Vioślarska, të ndodhur në pjesën juglindore të lumit Vistula.

Ndërkohë që pritet një vendim përfundimtar, bashkia e qytetit do t'ia shesë truallin kishës me 95% ulje, me kushtin se nuk do ta shesin dhe se në 10 vitet e ardhshme nuk do ta përdorin për asnjë qëllim tjetër, përveç atij të cilin ranë dakord.

Këto kushte të shitblerjes së pronave u miratuan nga shteti që në vitin 1997. Që nga viti 2008, bashkia e Krakovit i ka shitur Kishës Romano-Katolike 9 truaj toke, me nga 70-90% ulje për secilën.

radiongjallja.org